

Perspektiva e liberalizimit të vizave për Kosovën

Letër e hapur udhëheqjes së BE-së dhe përfaqësive e pranisë së BE-së në Kosovë

z. José Manuel BARROSO, President i Komisionit Evropian
z. Martin SCHULZ, President i Parlamentit Evropian
z. Evangelos VENIZELOS, Shef i Presidencës Greke të Këshillit të Bashkimit Evropian
Baroneshës Catherine ASHTON, Përfaqësuese e Lartë e Unionit për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, dhe Zëvendëspresidente e Komisionit Evropian
z. Štefan FÜLE, Komisioner i BE-së për Zgjerim dhe Politikën Evropiane të Fqinjësisë
z. Cecilia MALMSTRÖM, Komisionere e BE-së për Çështje të Brendshme
z. Ulrike LUNACEK, Raportuese e Parlamentit Evropian për Kosovën
z. Samuel ŽBOGAR, Shef i Zyrës së BE-së dhe Përfaqësues Special i BE-së në Kosovë
Ambasadave dhe Zyrave Ndërlidhëse të Shteteve Anëtare të BE-së të akredituara në Prishtinë

Të nderuar Shkëlqesi,

Para së gjithash, na lejoni të shprehim mirënjohjen dhe konsideratat më të larta të kosovarëve dhe tonat për mbështetjen e vazhdueshme ofruar Kosovës nga ana e BE-së dhe Shteteve të saja Anëtare në rrugën e saj të shtet-ndërtimit dhe integritimit në BE. Qëllimi i kësaj letre është të ndajmë me ju shqetësimin tonë të thellë për situatën shqetësuese në të cilën Kosova dhe qytetarët e saj gjenden sa i përket perspektivës së liberalizimit të vizave.

Mbi një dekadë më parë, në vitin 2003, Samiti i përbashkët i BE - Ballkan Perëndimor i Selanikut shënoi një zhvendosje të qasjes së BE-së ndaj evropianizimit të shoqërive ballkanike të dala nga konflikti. Kjo ishte arritur përmes inicimit të perspektivës së liberalizimit të vizave, përveç procesit të aderimit, të bazuar në mekanizmin e procesit të Stabilizim-Asociimit (PSA). Përveç ofrimit të stimujve për zbatimin e reformave dhe promovimin e sundimit të ligjit në vend, perspektiva për t'u bërë pjesë e 'Schengenit të bardhë' është perceptuar qysh atëherë si një qasje e orientuar kah njerëzit, e cila pritet të sjellë përmirësime të prekshme në jetën e qytetarëve, përtej PSA-së shumë politik dhe gjithëpërfshirës. Si e tillë, kjo ka krijuar pritje të forta në mesin e qytetarëve të vendeve në të gjithë rajonin se politika e BE-së e kushtëzueshmërisë për aderim po pasurohej edhe më tej me vlera të drejtësisë dhe përfshirjes, e shtyrë nga ajo që liria e lëvizjes po promovohet si një nga të drejtat themelore të njeriut në mbarë kontinentin e vjetër.

Dhe jo vetëm kaq. Një ndryshim i tillë shumë i rëndësishëm ka krijuar gradualisht një besim të gjerë se liberalizimi i vizave nuk ka të bëjë vetëm me reformat dhe lirinë e lëvizjes si e drejtë themelore e njeriut, por se gjithashtu nxit zhvillimin socio-ekonomik për të gjithë. Një besim i tillë ishte i

frymëzuar nga pritja, ashtu siç ishte promovuar edhe nga vetë BE, se të qenit pjesë e ‘Schengenit të bardhë’ do të përmirësonte qasjen e të rinjve në mundësi më të mira për arsimim, si dhe të biznesmenëve dhe profesionistëve në tregje dhe mundësi për zhvillim profesional më konkurruese të ofruara nga tregu i brendshëm i BE-së dhe tregjet rajonale. Në të vërtetë, një pritje shumë më e rëndësishme akoma qëndron, pra se sapo që heqja e regjimit të vizave Schengen të bëhet hisë e besueshme politike, me të vërtetë me vlerë për të investuar në të për cilëndo shoqëri, kjo sigurisht vepron kundër euroskepticizmit dhe kontribuon që gradualisht të sjellë vlerat e tyre më afër atyre të shoqërive të zhvilluara evropiane. Të shtyrë thellësisht nga vlera dhe besime të përbashkëta fundamentale, BE dhe të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor bashkërisht kishin ndërmarrë hapa të shpejtë për të avancuar nga lehtësimi drejt liberalizimit të vizave brenda afërsisht dy vjetësh, por megjithatë vetëm Kosova ishte përjashtuar nga kjo. Proceset përkatëse me këto vende kishin siguruar qartësi, parashikueshmëri, drejtësi në sytë e publikut dhe qasje realiste, të kombinuara me udhëzime të hollësishme nga ana e BE-së gjatë gjithë rrugës, bazuar në partneritet dhe besim të plotë reciprok.

Në anën tjetër, ndonëse Kosova i ka hyrë përmbushjes së kriterëve të kërkuara që nga viti 2009 dhe ka marrë udhërrëfyesin e saj të vizave në vitin 2012, ajo po hyn në vitin e tretë në këtë proces. Përveç kësaj, ajo është zyrtarisht pjesë e Procesit të Stabilizim-Asociimit (që mbulon, ndër të tjera, të njëjtat sektorë që mbulon ky udhërrëfyes) që nga viti 2003 dhe pret të nënshkruajë një MSA së shpejti brenda këtij viti. Kosova është gjithashtu, që nga viti 2012, e përfshirë në një të ashtuquajtur ‘dialog të strukturuar mbi sundimin e ligjit’, një shpikje kjo e llojit të vet që thuhet se trajton po të njëjtit sektorë si udhërrëfyesi. Për më tepër, Kosova po hyn në vitin e gjashtë që mban brenda vendit misionin më të madh ndonjëherë të BE-së për sundimin e ligjit dhe vazhdon dialogun me Serbinë, të dyja këto të portretizuara si veprime për ta sjellë atë më pranë BE-së dhe përmirësuar jetën e qytetarëve të saj. Dy të fundit janë përqaftuar nga udhëheqja e Kosovës përkundër përkrahjes në rënie nga ana e publikut brenda vendit, për shkak të zhgënjimit me punën e EULEX-it për të dhënë rezultate të drejtësisë dhe sundimit të ligjit dhe faktit se ky dialog po çon tejte ngadalë qoftë në përmirësimin e jetës së qytetarëve, qoftë në afrimin e Kosovës me BE-në. Në të kundërtën, perspektiva e liberalizimit të vizave mbetet po aq larg, ndoshta edhe më e mjegullt se për disa nga ish-republika sovjetike.

Duam të ndajmë me ju shqetësimin tonë të thellë për faktin se askush nuk duket të ketë ndonjë ide të qartë se kur dy milionë njerëzit e fundit që jetojnë në Evropë më në fund do tu bashkohen pjesës tjetër prej qindra milionë evropianëve të cilët gëzojnë të drejtën themelore njerëzore për lëvizje të lirë.

Askush prej nesh nuk duhet të harrojmë se Kosova mbetet ndër vendet më të izoluara në glob, pasi që qytetarëve të saj u lejohet të udhëtojnë pa viza në vetëm rreth pesë vende. Shikuar me sytë e një qytetari të zakonshëm që jeton këtë realitet çdo ditë, kjo lë kurrfarë perceptimi tjetër përveç një paradoksi. Një paradoks i tillë i qenësishëm qëndron pikërisht në kundërthënien ndërmjet vullnetit të deklaruar nga ana e BE-së për integrimin e Kosovës (pavarësisht qëndrimeve të shteteve anëtare ndaj shtetësisë) dhe faktit se ajo çfarë faktikisht bën në terren rrezikon të marrë një kah të kundërt gjatë procesit. Është e qartë se sa më shumë që të zvarritet ky proces, aq më shumë njerëzit e zakonshëm do të përpiqen ta thyjnë izolimin në kërkim të jetës më të mirë, gjithashtu duke pasur parasysh faktin se procesi i aderimit sigurisht se do të marrë të paktën edhe një dekadë. Shikuar në këtë dritë, është e domosdoshme që rrezikut të mundshëm nga izolimi i vazhdueshëm duhet t’i kushtohet vëmendje dhe t’i jepet përgjigje. Radikalizimi dhe ekstremizmi i mundshëm, qoftë ai etnik, politik, fetar apo i çfarëdo lloji tjetër, do të paraqiste rrezik shumë serioz ndaj rendit publik dhe kushtetues të Kosovës, duke minuar potencialisht edhe tek vet themelet e Kosovës. Duke qenë se komunikimi me shoqëritë më të zhvilluara përreth është i mbyllur, ne rrezikojmë të marrim rrugën e një shoqërie të pasigurt.

Duke njohur plotësisht përpjekjet e tyre të deritanishme, nga pikëpamja e shoqërisë civile dhe publikut të gjerë, ne konsiderojmë se të gjitha institucionet dhe akterët politikë të Kosovës, nga njëra anë, dhe të BE-së, nga ana tjetër, akoma nuk kanë demonstruar përkushtim, aftësi profesionale, sinqeritet dhe seriozitet të plotë dhe të qartë në përbushjen e të gjitha kriterëve të përcaktuara në Udhërrëfyesin për Liberalizimin e Vizave për Kosovën. Rrjedhimisht, na lejoni të përvijojmë një numër kërkesash, si për BE-në ashtu edhe institucionet e Kosovës, të cilat i shohim si kyçe nëse do të duhej filluar me adresimin e shqetësimeve të thella të ngritura në këtë letër.

- Para së gjithash, të dyja palët duhet të dalin me një vlerësim të përbashkët që tregon në mënyrë të qartë secilin kriter, një nga një, që Kosova ka përbushur dhe një listë të secilit kriter të mbetur. Një listë e tillë duhet të jetë e qartë, sidomos sa u përket masave të sakta të dakorduara për t'u ndërmarrë për të përbushur kriteret e mbetura dhe një afat kohor për zbatim. Ajo gjithashtu duhet të jetë plotësisht transparente dhe lehtësisht e qasshme për publikun. Në anën tjetër, BE duhet të vendosë një afat të qartë kohor për vlerësimin e rregullt të progresit të bërë nga Kosova në përbushjen e kriterëve të mbetura. Një kornizë e tillë kohore gjithashtu duhet të jetë e qartë strukturalist dhe në aspektin e afateve kohore të ezauruar, si dhe, ç'është më e rëndësishmja, ta trajtojë Kosovën në mënyrë të drejtë dhe të barabartë me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor para saj. Një kornizë e tillë kohore dhe të gjitha dokumentet e ndërlidhur me të gjithashtu duhet të jenë plotësisht transparente dhe lehtësisht të qasshme për publikun. BE duhet të ketë parasysh se shtimi i vazhdueshëm i kriterëve tejte margjinale, në çfarëdo forme, dhe vlerësimi i zbatimit të tyre kaq rrallë sigurisht se do të jetë kundër-produktiv në arritjen e përbushjes së tyre, pasi që vetëm do të do të humbte fokusin dhe në fund të fundit të dobësonte përkushtimin e të dy palëve ndaj vetë procesit dhe besimin e publikut në të. Rreziku i një 'lodhjeje nga liberalizimi i vizave' është në mënyrë të qartë shumë i drejtpërdrejtë.
- Së dyti, gjithashtu duhet të vendosen linja të qarta të llogaridhënie, si në anën e Kosovës, ashtu edhe atë të BE-së, dhe kjo t'i komunikohet publikut. Kjo gjithashtu kërkon ndarje të qartë të përgjegjësi në të gjitha hierarkitë përkatëse institucionale (siç përshkruhet nga vetë funksionet përkatëse të tyre), duke shmangur mbivendosjet ekzistuese ndërmjet sektorëve dhe niveleve të institucioneve, përfshirë kur është fjala për monitorimin, raportimin dhe vlerësimin. Ky proces, megjithatë, duhet të sigurojë përfshirjen e palëve të interesuara dhe përgjigjshmëri. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, në këtë aspekt, strukturat e koordinimit të vendosura, të të dyja palëve dhe në të gjitha nivelet, duhet të jenë vetëm instrumente në shërbim të qëllimit (zbatimin e udhërrëfyesit), e jo të degjenerojnë në qëllime në vetvete. Një strukturë e tillë duket të jetë 'dialogu i strukturuar për sundimin e ligjit', i cili duket se mbivendoset dhe rrezikon të bëhet një qëllim në vetvete.
- Së treti, duhet vendosur dhe ruajtur llogaridhënie e transparencë ndaj publikut dhe pjesëmarrje të përmirësuar të shoqërisë civile. Kjo kërkon sigurimin e qasjes së publikut në informata që pasqyrojnë të gjitha përmasat dhe proceset që janë zhvilluar që kur Kosova ka marrë udhërrëfyesin dhe deri në fund të procesit. Informatat e tilla, përfshijnë, por jo vetëm, dokumente planifikuese, raportuese dhe vlerësuese të nxjerra nga të dyja palët, si dhe konkluzionet e të gjithave takimeve zyrtare, në veçanti ato të nivelit politik. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, sa i përket transparencës, komunikatat e përbashkëta për shtyp dhe paraqitjet e përbashkëta mediale janë praktika të zakonshme në çdo sistem politik demokratik, dhe si të tilla duhet të jenë pjesë e çdo takimi të nivelit politik për liberalizimin e vizave

ndërmjet BE-së dhe Kosovës. Në anën tjetër, shoqëria civile do të sillte vlerë të shtuar në proces nëse do t'i mundësohej të sillte më shumë nga pikëpamjet e veta dhe të ushtronte më tepër presion të organizuar.

- Së katërti, roli i EULEX-it dhe e ardhmja e tij janë të lidhura pazgjidhshmërisht me procesin e liberalizimit të vizave. Sa i përket rolit të tij, udhërrëfytesë në mënyrë të qartë përcakton kriteret në përmbushjen e të cilave EULEX-i duhet nëpërmjet përfshirjes së efektshme. Ndonëse shpeshherë këto mund të keqinterpretohen si detyra ekskluzivisht të institucioneve të Kosovës vis-à-vis EULEX-it si mision i BE-së, kjo përfundimisht duhet të shihet si një qasje plotësisht e ndërsjellë. Kjo kërkon qartësi në përkufizimin e detyrave të sakta të EULEX-it marrë parasysh natyrën e plotë të mandatit të tij, sidomos kur është fjala për 'mandatin ekzekutiv' dhe çështjet e anëtarësimit në dhe bashkëpunimit me organizatat dhe mekanizmat relevantë ndërkombëtarë e rajonalë, ku edhe duket të ketë më së paku përparime. Në këtë drejtim, vetë fakti që të gjitha shtetet anëtare janë në favor që Kosova të jetë pjesë e 'Schengenit të bardhë' i lejon më shumë hapësirë BE-së që të luajë një rol më proaktiv të ndërmjetësuesit në drejtimin që Kosova zyrtarisht të anëtarësohet dhe të vendosë e ruajë bashkëpunimin me organizatat dhe mekanizmat e tillë. Për më tepër, të dyja palët duhet të pranojnë ndjeshmëritë politike që mund të dalin për Kosovën, në përgjithësi, nga shtyrja e pafund e mandatit të EULEX-it, në veçanti marrë parasysh zhgënjimin e publikut me punën e tij, perceptim ky nganjëherë gjithashtu i pranuar dhe i përbashkët me akterë të caktuar të BE-së.
- Së fundi, dialogu politik me shtetet anëtare është kyç. Kjo kërkon që të gjithë vendimmarrësit relevantë politik (përfshirë ligjvënësit) të të dyja palëve të angazhohen shumë më tepër me njëri-tjetrin në ndërtimin e një kuptimi më të thellë të të gjitha kritereve si dhe sfidave me të cilat përballlet Kosova në përmbushjen e secilit prej kritereve. Përveç kësaj, kjo kërkon që pala kosovare të angazhohet drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë të vazhdueshme me shtetet anëtare të BE-së, me lehtësimin e BE-së (aty ku është e nevojshme). Dhe jo vetëm me ta, por gjithashtu me organizatat dhe mekanizmat përkatës ndërkombëtarë e rajonalë dhe me vendet e rajonit. E fundit, por jo më pak e rëndësishme në këtë drejtim, të dyja palët duhet të mendojnë në mënyrë kreative se si ta bëjnë dialogun me Serbinë më strukturalisht të kushtëzuar drejt lehtësimit të përmbushjes së kritereve për liberalizimin e vizave.

Për të përfunduar, me anë të kësaj letre të hapur synojmë të shprehim besimin e qytetarëve tanë se ka ardhur koha që ju dhe udhëheqësit tanë të ndani në mënyrë të barabartë të gjitha shqetësimet e ngritura këtu. Duam të besojmë se ju do merrni në konsideratë në punën tuaj të përditshme të gjitha këto shqetësimet e ngritura këtu, si dhe shumë të tjera për të cilat tashmë jeni të njoftuar, dhe të ndërmerrni gjithçka që është në fuqinë tuaj në mënyrë që procesi i liberalizimit të vizave për Kosovën të mos ngeçë për shkak të neglizhencës. Kosovarët e meritojnë këtë nëse duhet t'i jepet fund hendekut midis pritjeve fillestare dhe pasigurisë së vazhdueshme rreth rezultatit përfundimtar të këtij procesi. Jemi të sigurt se kjo është gjithashtu në interesin më të mirë të BE-së.